

Shënim: Të dhënat "Përqindja e fëmijëve që jetojnë pa ujë të përmirësuar të pijshëm, energji elektrike, që jetojnë në banesa të papërshtatshme dhe përqindja e fëmijëve me 1 ose 2 prindër të pa punë",- janë marrë nga studimi i thelluar me autorë A. Ceni dhe V. Kolpeja.

Observatori për të drejtat e Fëmijëve, Qarku Kukës



Qarku i Kukësit kufizohet në lindje me Republikën e Kosovës, në perëndim me qarkun e Shkodrës, në veri me Malin e Zi, në jug me qarkun e Dibrës dhe pjesërisht atë te Lezhës (rrethin e Mirditës). Qarku i Kukësit ka në përbërjen e tij *27 njësi vendore* nga të cilat 24 komuna dhe 3 bashki.

Qendra administrative, politike, ekonomike dhe kulturore e qarkut është qyteti i Kukësit. Popullsia e qarkut të Kukësit në vitin 2010 ishte 109.732 banorë[1].Në vitin 2011 qarku Kukës numëron *26,406 familje,* nga te cilat *12,269* trajtohen me ndihmë ekonomike[2].

Më shumë informacion rreth qarkut mund të gjeni në faqen:
http://www.kqk.gov.al



[1] Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Mars 2011
[2] Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Kukës (2012)

Përshkrim mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Qark:

Qarku i Kukësit në vitin 2010, ka 109.732[3] banorë dhe *26,386*[4] familje në total. Nga numri total i familjeve në qark, 6.074 *familje (*20.83*%)* janë familje të varfra dhe kanë fëmijë (grupmosha 0-15 vjeç). Fëmijët (0-18 vjeç) përbëjnë *34.5 %* të popullsisë *(37,933 fëmijë)*.

Në vitin 2010 në Qarku e Kukësit *1 në 2 fëmijë* (*10,181* fëmijë) të grupmoshës 6-15 vjeç jeton në familje e cila trajtohet me Ndihmë Ekonomike (NE).

Në Qarkun e Kukësit, për vitin 2010 janë *781* fëmijë të moshës 0-18 vjeç me aftësi të kufizuar (PAK)[5], ose *2.1%* të fëmijëve. Nga të tre rrethet e Qarkut Kukës, Rrethi i Tropojës ka numrin më të lartë të fëmijëve me AK, përkatësisht *355 fëmijë (2.2%)*. Nëse krahasojmë numrin e fëmijëve që jetojnë në zonë urbane me ato në zonë rurale, rezulton se *301fëmijë (39%)* jetojnë në qytet dhe *480 fëmijë (61%)* me aftësi të kufizuar (0-18 vjeç) jetojnë në fshat.

Në vitin 2011 në Bashkinë e Bajram Curri është ngritur shërbimi për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

3. Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Bredhshme, Mars 2011
4. Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë (Prill 2011)
5. Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë (Prill 2011)









Në institucionet shtetërore dhe ato vendore vihet re një rritje e ndërgjegjësimit në drejtim të njohjes së të drejtave të fëmijëve.

	Has	Kukës	Tropojë
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin parashkollor[1]	647	1827	711
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin e detyruar[2]	3462	10036	4122
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin e mesëm[3]	902	2671	1237
Përqindja e fëmijëve që kanë braktisur shkollën[4]	0.05%	0.92%	0.04%

1. Drejtoria Arsimore Rajonale, - Kukës (Tetor 2011)
2. Ibid;
3. Ibid;
4. Të dhënat primare janë marrë nga Drejtoria Arsimore Rajonale, - Kukes, 2011 dhe përllogaritja e treguesit në përqindje është bërë nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve.

Fëmijët romë janë përqendruar kryesisht në qytetin e Kukësit, ardhur nga rrethet e tjera, si Krujë dhe Fier. Çdo pranverë ato vendosen në Kukës dhe familjarët i detyrojnë fëmijët të lypin në rrugët e Kosovës gjatë ditës për t'u kthyer përsëri në Kukës në darkë.

Shërbimet sociale janë të përqendruara tërësisht në bashkinë Kukës, ndërsa në njësitë e tjera vendore të Qarkut Kukës nuk ka shërbime të tilla me përjashtim të një zyre shërbimesh në bashkinë Bajram Curri me një punonjës të vetëm, i cili mbulon shërbimet për *fëmijët me aftësi të kufizuar dhe familjen pavarësisht se pretendohet* se ajo luan rolin e njësisë për mbrojtjen e fëmijëve ne Bajram Curri.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit 10347 në vitin 2010, është punuar në drejtim të njohjes dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve nga shoqata të ndryshme. Nga vëzhgimet e bëra në terren pushteti vendor në përgjithësi nuk ka planifikuar fonde me objektiva të veçanta për fëmijët.

Observatori për të drejtat e fëmijës është një strukturë vëzhguese e shoqërisë civile e ngritur ne qarkun e Kukësit në vitin 2008, e cila në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët vendorë publikë e jo-publikë bën mbledhjen sistematike të të dhënave dhe përgatit raporte dhe informacione periodike për aktorët lokalë dhe kombëtarë lidhur me situatën e fëmijëve, shkeljen e të drejtave, zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe nevojat për përmirësimin e tij të mëtejshëm.

Observatori për të drejtat e Fëmijëve, Qarku Kukës gjendet në:
L.5. Sheshi Skënderbej, Këshilli Qarkut kukës
Kukës, Shqipëri
e-mail: observatori_ku@yahoo.com
URL: www.observator.org.al

Politika Rajonale në ndikojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve

Qarku i Kukësit aktualisht nuk ka strategji rajonale për fëmijët, por ka ndërmarrë nismën për hartimin e një "Plani rajonal veprimi për fëmijët" në përputhje me "Planin kombëtar të veprimit për fëmijët" që do t'i bashkëngjitet *"Strategjisë rajonale të zhvillimit"* të Qarkut Kukës.

Në dobi të realizimit dhe përmbushjes të të drejtave të fëmijëve, në Qarkun Kukës, veç zyrës së Observatorit, është ngritur dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Fëmijëve" në Qark.


Numri i fëmijëve 0-18 vjeç me Afësi të Kufizuar
151
439
190
Has
Kukës
Tropojë


Përqindja e fëmijëve 0-18 vjeç me aftësi të kufizuar
2%
2%
2,20%
Has
Kukës
Tropojë


Përqindja e fëmijëve me 1 ose 2 prindër të pa punë
18,31%
19,98%
13,12%
Has
Kukës
Tropojë


Përqindja e fëmijëve që jetojnë në banesa të papërshtatshme
48,75%
53,20%
34,93%
Has
Kukës
Tropojë


Përqindja e fëmijëve që nuk kanë akses ndaj ujit të pijshëm të përmirësuar
14,18%
15,47%
10,16%
Has
Kukës
Tropojë


Përqindja e fëmijëve që jetojnë pa energji
48,67%
53,11%
34,87%
Has
Kukës
Tropojë


Përqindja e fëmijëve 6-15 vjeç që jetojnë në familje të cilat mbështeten me NE
RRETHI TROPOJE
Tropoje Fshat 8,13%
Margegaj
Llugaj
Lekbibaj 73,78%
Fierze 96,10%
Bytyç
Bujan 71,42%
Bajram Curri 43,63%
RRETHI KUKES
Kalis
Gryke Çaj
Ujmisht
Topojan
Terthore
Surroj 53,82%
Shtiqen 54,67%
Shishtavec 92,77%
Zapod Orgjost 81,12%
Malziu 75,38%
Kukes (Bashki) 47,38%
Kolsh
RRETHI HAS
Bushtrice 6,64%
Bicaj 66,68%
Arren
Krume 61,67%
Gjinaj
Golaj 63,29%
Fajza


Përqindja e fëmijëve 0-18 vjeç me aftësi të kufizuar
RRETHI TROPOJE
Tropoje Fshat 2,60%
Margegaj 2%
Llugaj 2,20%
Lekbibaj 2,60%
Fierze 0,80%
Bytyç 1,40%
Bujan 2,40%
Bajram Curri 2,40%
RRETHI KUKES
Kalis
Gryke Çaj
Ujmisht
Topojan 3%
Terthore 1,70%
Surroj 2,20%
Shtiqen 1,50%
Shishtavec 1,30%
Zapod Orgjost 1,80%
Malziu 1,90%
Kukes (Bashki) 2,50%
Kolsh
RRETHI HAS
Bushtrice 2%
Bicaj 1,50%
Arren
Krume 2,80%
Gjinaj
Golaj 1,30%
Fajza 1,50%